



KOMUNA GLLOGOC  
MUNICIPAL ASSEMBLY  
01 Nr. 110-6904  
Mb On 24 09 2008  
REPUBLIKA E KOSOVËS



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPALITY ASSAMBLE G L L O G O C**

# **STATUTI I KOMUNËS SË GLLOGOCIT**

**GLLOGOC, 16.09.2008**



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIK OF KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPALITY ASSAMBLE G L L O G O C**

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12.2 germa( a)dhe 12.3 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Kuvendi i Komunës së Glogocit në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2008, miratoi:

**STATUTIN  
E KOMUNËS SË GLLOGOCIT**

**PJESA I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Komuna e Glogocit është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Komuna e ka Statutin e vet.

Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës, që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Statuti rregullon organizimin e brendshëm të Komunës. Në përdorimin e mëtutjeshëm do të njihet si "Statuti i Komunës".

**Neni 2**

Përgjegjësitë e Komunës ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës me Ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e Komunës, me Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës të miratuar nga Kuvendi Komunës.

### Neni 3

- 3.1 Statuti i Komunës zbatohet vetëm brenda kufijve të Komunës së Glllogocit.
- 3.2 Selia e Komunës së Glllogocit (në tekstin e mëtejme: "Komuna") është në Glllogoc, në rrugën "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci".
- 3.3 Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saj tek Komunitat tjera apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me Komunitat tjera në pajtueshmëri me Ligjin në fuqi.
- 3.4 Komuna ka statusin e vet juridik si person juridik që përfshin të drejtën për të poseduar, për të qenë pronar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi, për të qenë i paditur në gjykatë si dhe të drejtën për të lidhur kontrata - marrëveshje dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë.
- 3.5 Komuna ka festat e veta, festat e Komunës janë: 14 Qershori -Dita e Çlirimit të Komunës dhe 28 Shkurti -Beteja e parë frontale e UÇK-së në Likoshan. Me rastin e festave të Komunës, Kuvendi i Komunës ndan tituj nderi, dekorata, mirënjohje, falënderime dhe shpërblime tjera të cilat me Vendim të veçantë Kuvendi i Komunës, përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies së shpërblimeve, dekoratave dhe mirënjohjeve.
- 3.6 Dita e dëshmorëve të Komunës do të caktohet me një Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës

### Neni 4

#### Organet e komunës janë:

- a) **Kuvendi i Komunës** është organi më i lartë vendimmarrës i Komunës;
- b) **Kryetari i Komunës** është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës;

### Neni 5

5.1 Komuna ushtron kompetencat **vetanake** dhe të **deleguara** në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Kompetenca të plota dhe ekluzive Komuna sa i përket interesit lokal ka në këto fusha si vijon:

- a) Ofrimin e kushteve themelore lokale për zhvillim të qëndrueshmërisë ekonomike;
- b) Planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës;
- c) Lëshimin e lejeve për ndërtime dhe zhvillime të tjera;
- d) Mbrojtjen lokale të ambientit;
- e) Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollimin e standardeve të ndërtimit;
- f) Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës, duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planin për ngrohtoret lokale;
- g) Shërbimet publike, duke përfshirë shërbimet e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- h) Menaxhimin e pronës komunale;

- i) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e insticioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- j) Kujdesin shëndetësor primar, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimi familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesi për të moshuarit duke përfshir regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionisteve të mirëqenies sociale;
- k) Shërbimet sociale dhe banim publik;
- l) Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik;
- m) Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjen në rrugë, transportin publik lokal dhe shërbimin e taksive, peshkimin, restorantet dhe hotelet;
- n) Panaiet dhe tregjet;
- o) Emërimin dhe rrimërimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- p) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave;
- r) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njëriut.
- q) aktivitetet tjera të ngjashme të nevojshme për administrimin adekuat të Komunës, që nuk janë të përcaktuara gjetiu me ligj.

5.2. Përveç aktiviteteve të caktuara me nenin 5.1, Komuna mund të ndërmarrë veprime në territorin e saj rreth çështjeve të tjera komunale.

**Këtu mund të përfshihen aktivitetet vijuese:**

- a) Turizmi;
- b) Aktivitetet kulturore;
- c) Sportet dhe aktivitetet e lira;
- d) Aktivitetet e rinisë,
- e) Avancimi i ekonomisë; si dhe
- f) Avancimi i vlerave qytetare.
- g) Komuna nxjerr rregullore lokale , merr vendime specifike që u përkasin çështjeve brenda kompetencave të Komunës dhe miratimi i tyre bëhet në bazë të Statutit të Komunës, të gjitha këto akte duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

5.3. Autoriteti qendror i Republikës së Kosovës, Komunës mund t'i delegojë këto kompetenca shtesë duke përfshirë të dhënat kadastrale, regjistrimin e bizneseve dhe licencimin, regjistrimin e votuesve, distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve), mbrojtjen e pyjeve në territorin e komunës duke përfshirë e dhenien e licencave për prerjen e drunjeve në bazë të rregullave të miratuara nga qeveria për realizimin e këtyre qëllimeve, Komunës do t'i sigurohen burimet përkatëse nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5.4. Në pajtim me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, Kuvendi i Komunës për veteranët , invalidët e anëtarët e UÇK-së dhe anëtarëve të ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe martirëve, invalidëve, veteranëve të UÇK-së, anëtarëve të ngushtë të familjeve të të zhdukurve ju siguron këto të drejta :

- a) Përparësi në punësim në kushte të barabarta;
- b) Përparësi regjistrimi në institucionet arsimore;
- c) Bursa për shkollim;
- d) Tekste shkollore falas për të gjitha nivelet , me përjashtim të nivelit të lartë;
- e) Përkujdesje për banim;
- f) Përkujdesje falas në institucione shëndetësore publike,
- g) Shpenzime të varrimit.
- h) Lirim nga pagesa e taksave komunale dhe beneficione tjera që do të përcaktohen me vendim të posaçëm.

#### **Neni 6**

6.1 Komuna ka emblemën dhe flamurin e vet. Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës dhe flamurit do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

6.2 Asnjë subjekt dhe person tjetër, përveç Komunës, nuk mund ta përdorë emblemën, flamurin dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.

#### **Neni 7**

Komuna e ka vulën e vet katrore dhe të rrumbullakët. Mënyra e mbajtjes dhe udhëheqjes së vulave do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës, i nxjerr në pajtim me aktet ligjore në fuqi të cilat rregullojnë këtë lëmi në Republikën e Kosovës.

### **PJESA II**

#### **PROCEDURAT PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË STATUTIT TË KOMUNËS**

#### **Neni 8**

8.1 Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës mund të ndërmerret nga:

- a) Kryetari i Komunës;
- b) Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
- c) Me iniciativën e 10% të qytetarëve me të drejtë vote në Komunë.

8.2 Propozimi për ndryshimin e Statutit Komunal duhet të dërgohet tek Kuvendi i Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës para shqyrtimit final duhet ta konsultojë publikun në lidhje me atë propozim.

8.3 Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës.

- 8.4 Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi i Komunës duhet të vendosë se a do ta miratojë Statutin me ndryshime, pas shqyrtimit të të gjitha vërejtjeve të marra.
- 8.5 Miratimi i Statutit të ndryshuar dhe plotësuar nga ana e Kuvendit të Komunës do të bëhet me votim të hapët me më shumë se 2/3 të anëtarëve të pranishëm që votojnë në mbledhje ku shqyrtohet propozimi .

### PJESA III

#### FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

##### Neni 9

9.1 Komuna është njësi territoriale dhe përbëhet prej qytetit Glllogoc dhe fshatrave dhe lagjeve si vijon:

1. Abri e Epërme,
2. Arllat,
3. Baicë, (Rrëzistencë)
4. Bytyq,
5. Çikatovë e Re (Drenasi III)
6. Çikatovë e Vjetër
7. Domanek,
8. Dobroshec, (Dritan)
9. Fushticë e Epërme,
10. Fushticë e Poshtme,
11. Gjergjicë, (Gjergjaj)
12. Glllobar,
13. Gllanasellë, (Shkabaj)
14. Godanc, (Shpat)
15. Gradicë
16. Kishnarekë, (Krujë)
17. Komoran, (Bushat)
18. Korroticë e Epërme,
19. Korroticë e Poshtme,
20. Krajkovë, (Kraikové)
21. Likoshan,
22. Llapushnik,
23. Negroc, (Fatos)
24. Nekoc, (Nikaj)
25. Poklek i Ri,
26. Poklek i Vjetër,
27. Polluzhë,
28. Sankoc, (Flamuraj)
29. Shtrubullojë, (Drenor)
30. Shtuticë, (Kodër)

31. Tërdec, (Brykuz)
32. Tërstenik, (Qendresë)
33. Vasilevë,
34. Verboc, (Fortesë)
35. Vuçak, (Nenkala)
36. Zabel i Epërm,
37. Zabel i Ultë.

#### 9.2 Lagjet Urbane janë:

1. Gllgoci I, (Drenasi I)
2. Gllgoci II, (Drenasi II)
3. Gllgoci III, (Çikatova e Re) (Drenasi III)
4. Komorani I, Lagja e Re. (Bushati I, Bushati II, Bushati III dhe Bushati IV)
5. Lagja e Dëshmorëve në Paklek të Ri dhe
6. Lagja e Feronikelit.

## KAPITULLI I

### MARRËDHËNIET ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

#### Neni 10

Komuna mund të bejë marrëveshje me fshatrat, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të komunës, forma e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane do të përcaktohet me rregullore lokale dhe udhëzimeve që i lëshon Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

#### Neni 11

11.1 Kuvendi i Komunës, varësisht nga dispozitat e Rregullores dhe të Statutit të Komunës, mund të delegojë aktivitete në lidhje me dispozitat e shërbimeve komunale në fshatra, vendbanim dhe lagje urbane

11.2 Komiteti për Politikë dhe Financa i shqyrton dhe i propozon Kuvendit të Komunës një numër të funksioneve të veçanta të cilat mund të ushtrohen nga përfaqësuesit e fshatrave, të vendbanimeve dhe të lagjeve urbane në pajtim me udhëzime të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

#### Neni 12

Gjatë secilit vjet fiskal, Kuvendi i Komunës do të mbikëqyrë zbatimin e atyre funksioneve të deleguara në pajtim me Statutin.

## PJESA E IV

### KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

#### KAPITULLI I

#### KONSULTIMET ME PUBLIKUN

##### Neni 13

13.1 Komuna duhet ta konsultojë publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte, dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve si dhe që janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, si dhe që të gjitha vendimet e propozuara mund të implementohen në praktikë.

13.2 Komuna gjithashtu duhet të sigurojë që qytetarët kanë pasur mundësi ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre janë marrë parasysh.

##### Neni 14

Komuna mund të shfrytëzojë secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë (si dhe format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):

1. Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
2. Kontaktet me grupet e fokusit, për t'i testuar dhe diskutuar politikën;
3. Anketat për implementimin e politikës, përfshirë përveç të tjerave informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo;
4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft-rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje në prezantime;
5. Kontaktet me grupet e interesit dhe mbledhjet me grupet e interesit;
6. Takimet publike;
7. Dëgjimet publike;
8. Studimet për vlerësim të efektit.

##### Neni 15

Kryetari, Drejtorët dhe Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës duhet ta kenë autoritetin të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që janë në kompetencat e tyre.

##### Neni 16

Në secilin rast duhet të jepet një arsyetim për mbajtjen e konsultave me publikun. Mënyra e cila shfrytëzohet për mbajtjen e konsultave me publikun duhet të publikohet 14 ditë përpara dhe duhet të lejohet kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve.

Rezultatet e konsultimeve duhet të merren parasysh dhe duhet të bëhen publike para se të merret vendimi.

#### **Neni 17**

17.1 Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta, dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t'i lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje, prej dy faqesh më së shumti, të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre, do të jetë më e lehtë për lexuesit të përgjigjen, të kontaktojnë apo të ankohen.

17.2 Kur përcaktohen grupet e fokusit në procesin e konsultimit, Komuna duhet të sigurojë që palët relevante kanë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

#### **Neni 18**

Komuna duhet të sigurojë publicitetin e duhur dhe duhet t'i adoptojë kanalet komunikuese në mënyrë që të përmbushë synimet e audiencës. Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare të Komunës.

#### **Neni 19**

Komuna duhet të lejojë kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet t'i lejojë së paku 8 javë për marrjen e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut, ndërsa standardi duhet të jetë 12 javë.

#### **Neni 20**

Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në faqen zyrtare të Komunës.

### **KAPITULLI II**

#### **TUBIMET ME PUBLIKUN**

#### **Neni 21**

21.1 Takimet me publikun duhet të mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.

21.2 Përveç kësaj, takimet tjera me publikun mund të mbahen, duke marrë parasysh se duhet të ekzistojë një interval prej dy muajsh ndërmjet dy takimeve.

## Neni 22

22.1 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Takimet publike duhet të mos mbahen në datat apo kohën që në përgjithësi nuk është e përshtatshme për pjesëmarrjen e komuniteteve të veçanta.

22.2 Përfaqësuesit e mediave duhet të lejohen të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.

## Neni 23

23.1 Kryetari apo përfaqësuesit e tij/saj, duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes si dhe ka autoritetin të mos lejojë diskutimin për disa çështje të caktuara që nuk janë të lidhura me çështjet e diskutuara apo që nuk janë në kuadër të pushtetit të Komunës ose edhe nuk kanë të bëjnë me punët e Komunës.

23.2 Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

## Neni 24

Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh pas ditës së takimit.

## Neni 25

Procesverbali i secilit takim publik duhet të ruhet me të gjitha informatat të hollësishme që jepen për Komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e publikut dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim, në ndonjë datë të mëvonshme duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

## Neni 26

Komiteti për Politikë dhe Financa duhet ta shqyrtojë procesverbalin e mbledhjes publike brenda 60 ditëve pas mbledhjes. Komiteti duhet ta shqyrtojë secilin propozim të dhënë gjatë mbledhjes dhe, pas kryerjes së konsultimeve të nevojshme, të bëjë rekomandimet e duhura në takimin e ardhshëm të Kuvendit të Komunës.

## PETICIONI

### Neni 27

Qytetarët e Komunës si dhe organizatat tjera kanë të drejtë që t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës.

Çështja e peticionit më për së afërmi rregullohet me Rregulloren Komunale për konsultim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.

## REFERENDUMI

### Neni 28

28.1 .Kuvendi i Komunës mund të organizojë mbajtjen e Referendumit si formë e deklaramit personal për çështjet dhe përgjegjësitë komunale në pajtim me dispozitat e Ligjit për referendum.

28.2. Qytetarët e komunës mund të kërkojnë që rregullorja e kuvendit të komunës e miratuar nga kuvendi i komunës ti nenshtrohet referendumit, kërkesa duhet ti dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores dhe kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga 10% e votuesve të regjistruar në komunë.

28.3. Kuvendi i komunës kërkesën duhet ta shqyrtoi brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit në pajtim me ligjin në fuqi.

## QASJA NË DOKUMENTE ZYRTARE

### Neni 29

Qasja në dokumentet zyrtare komunale është e rregulluar më për së afërmi me Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare nr. 2003/12, i shpallur në fletoren zyrtare të UNMIK-ut nr. 2003/32 si dhe në Rregulloren Komunale për konsultim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.

## GJUHA ZYRTARE

### Neni 30

Çështja e gjuhës zyrtare në përdorim është rregulluar me Ligjin për përdorimin e gjuhës zyrtare si dhe me Rregulloren Komunale për përdorimin e gjuhës zyrtare në Komunë.

### KAPITULLI III

#### KOMITETET KËSHILLDHËNËSE

##### Neni 31

Kuvendi i Komunës duhet të krijojë Komitetet Këshillëdhënëse Sektoriale që do të mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, Kuvendi i Komunës duhet të sigurojë një përfaqësim të gjerë nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, në krijimin e këtyre komiteteve duhet të merret parasysh bilanci gjinor dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese dhe/apo fshatrave brenda Komunës.

##### Neni 32

Komitetet Këshillëdhënëse duhet të paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve tek Kuvendi i Komunës. Ata gjithashtu duhet të monitorojnë ofrimin e shërbimeve në sektorët relevantë dhe të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara. Në kryerjen e detyrave të tyre, Komitetet Këshillëdhënëse duhet të punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në mënyrë të tillë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit Plenar duhet të merren vetëm pas konsultimit me Komitetin Këshillëdhënës Sektorial.

##### Neni 33

Anëtarët e Komiteteve Këshillëdhënëse duhet të emërohen me mandat 3 vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit. Asnjë anëtar i Komitetit Këshillëdhënës nuk mund të shërbejë më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

### PJESA E V

#### KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI I KK DHE KOMITETI I TIJ

### KAPITULLI I

#### KUVENDI I KOMUNËS

##### Neni 34

34.1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale

34.2. Kuvendi i Komunës mban mbledhjen e parë inauguruese brenda 15 ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore. Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari i komunës nese është zgjedhur. Nese kryetari i komunës

nuk është zgjedhur, mbledhjen inaguruese e thërret anëtari më i vjetër apo me iniciativën e shumicës së anëtarëve. Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është katër vite. Anëtari më i moshuar i Kuvendit e kryeson mbledhjen derisa Kryesuesi ta bëjë betimin. Anëtarët bëjnë betimin dhe e nënshkruajnë.

Përmbajtja e betimit është:

“Unë \_\_\_\_\_, betohem se do t’i kryej detyrat me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, si dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë”

34.3. Kuvendi i Komunës ka 31 anëtarë, miraton Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme . Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Statutit miratohet me më shumë se dy të tretat e Anëtarëve të Kuvendit si dhe miraton Rregulloren e punës dhe ndryshimin me shumicën e anëtarëve të Kuvendi.

34.4. Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij,
- b) nëse ndërron vendbanimin ku është zgjedhur,
- c) nëse paraqet dorëheqje me shkrim.
- d) nëse anëtari ka qenë i denuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhëri për burgim për gjashtë muaj ose më shumë.
- e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre muaj rresht në mbledhje të Kuvendit të Komunës pa arsye apo nëse ligji në fuqi nuk i lejon të kandidohet për anëtar duke e konsideruar të papërzgjedhshëm.

34.5. Anëtari i Kuvendit të Komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

34.6. Kuvendi i Komunës nuk mund të delegojë përgjegjësinë e vet për marrjen e Vendimeve lidhur me:

- a) Miratimin e Statutit dhe Rregulloren e punës, Rregulloret komunale, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre
- b) miratimin e buxhetit;
- c) miratimin e çështjeve tjera financiare të cilat sipas Statutit dhe Rregulloreve të punës janë rezervuar për Kuvendin;
- d) kompensimet për këshilltarët e zgjedhur;
- e) raportin vjetor;
- f) miratimin, ndryshimin dhe anulimin e Rregulloreve Lokale Komunale,
- g) krijimin e Komiteteve që kërkohen me këtë Rregullore;
- h) zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
- i) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- j) lartësinë e tarifave dhe ngarkesave;
- k) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit, në përputhje me ligjin në fuqi;
- l) emërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve, shesheve dhe vendbanimeve të tjera publike dhe
- ll) marrjen e vendimeve për tu bashkuar asociacioneve të komunave të Republikës së Kosovës

34.7. Kuvendi i Komunës mund t’i delegojë pushtetin për të marrë vendime një Komiteti të Kuvendit të Komunës ose Kryetarit të Komunës.

Kuvendi i Komunës mund të revokojë delegimin në çdo kohë.  
34.8. Vendimi për emërtimin apo për riemërtimin e çfarëdo rrugice, rrugë apo vendi tjetër publik miratohet nga më së paku dy të tretat e Këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

## KAPITULLI II

### KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

#### Neni 35

Kuvendi i Komunës zgjedh kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga radhët e anëtarëve për një mandat të njëjtë si anëtarët e kuvendit me vota të fshehta. Për tu zgjedhur në votimin e parë kandidati duhet ti marrë më shumë së gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur në rast së në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar atëherë dy kandidatët me numër më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet Kryesues i Kuvendit.

#### Neni 36

Kryesuesi i Kuvendit thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit. Mënyra e thirrjes dhe udhëheqjes së mbledhjeve të Kuvendit rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit.

#### Neni 37

37.1. Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Rregullorja e Punës rregullon se kush konvokon dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

37.2. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij përbëhet nga gjysma (50%+ 1) e anëtarëve të pranishëm në mbledhje me të drejtë pjesëmarrje dhe votimi.

37.3. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve, të gjithë anëtarët kanë një votë. Kryesuesi i Kuvendit Komunal ka votën vendimtare në rast të numërimit të njëjtë të votave PËR ose KUNDËR ndonjë propozimi.

37.4. Kuvendi dhe Komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nese me ligj nuk kërkohet ndryshe.

37.5. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij merren me shumicën e thjeshtë të këshilltarëve të pranishëm dhe të cilët votojnë, përveç nëse me ligj nuk kërkohet ndryshe.

37.6. Kuvendi i Komunës mbledhet sa herë që kjo parashihet me Rregulloren e punës, por mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të thirren edhe nga  $\frac{1}{4}$  i numrit të të gjithë këshilltarëve të zgjedhur së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të Kuvendit të Komunës ose tri ditë pune me herët në raste urgjente dhe për mbledhje Këshilltarëve do t'ju dërgohen thirrjet me material të rendit të ditës.

37.8. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij mbahet procesverbal i cili përfshin emrat e anëtarëve të pranishëm dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse është e nevojshme thirret emri i çdo anëtari dhe në procesverbal shënohet se si ka votuar secili. Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal i caktuar nga Kryetari i Komunës i cili duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme dhe të njëjtin ka të drejtë ta shikojë çdokush dhe ta marrë një kopje.

Kryesuesi i Kuvendit e nënshkruan procesverbalin e miratuar.

37.9. Nëse Kuvendi i Komunës dështon në kryerjen e funksioneve të detyrueshme sipas ligjit apo nëse bëhet jofunksionues në ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve Ministria për Qeverisje Lokale njofton komunën për dështime duke propozuar masa të duhura për sigurimin e qetë të funksionit komunal.

37.10. Kuvendi i Komunës konsiderohet ju funksionues nëse:

a) nuk e zgjedh kryesuesin tridhjetë (30) ditë pas themelimit,

b) nuk miraton Statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit,

c) nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës ose

d) nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë së gjashtë muaj.

37.11. Ministria e Pushetetit Lokal e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e komunës. Qeveria shpërndan Kuvendin e Komunës jofunksional.

37.11. Zgjedhjet e reja për Kuvend Komunal mbahën në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet Komunale.

### KAPITULLI III

#### KOMITETET E PËRHERSHME DHE KOMITETET TJERA

##### Neni 38

38.1 Pas konstitimit, Kuvendi i Komunës formon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera, nëse konsideron së janë të nevojshme.

38.2 Numri i anëtarëve të Kuvendit në secilin komitetet duhet të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës.

38.3 Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës anëtarët e komiteteve, që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

### Neni 39

Kuvendi i Komunës formon Komitetin për Politikë e Financa si dhe Komitetet tjera në vështrim të nenit 51.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale pas sigurimit të buxhetit nga Kuvendi i Komunës.

### Neni 40

Në takimet e tyre të para në secilin vit fiskal Kuvendi i Komunës dhe secili Komitetet duhet t'i caktojë datat fikse në të cilat duhet të mbahen takimet e rregullta gjatë vitit. Datat e mbajtjes së takimeve mund të ndryshohen me vendime pasuese. Takimet tjera mund të thirren në çdo kohë.

### Neni 41

Të gjitha takimet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës. Personi i cili thërret apo udhëheq takimet duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta, dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në gjithë veprimet.

### Neni 42

42.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara që është objekt diskutimi përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

42.2 Kuvendi i Komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton Publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme, ndër të tjera me mjetet e mëposhtme:

- a) Shpallja publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
- b) Median e shkruar dhe elektronike lokale dhe
- c) Faqen e internetit të Kuvendit të Komunës.

42.3 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes;
- b) Kohën e mbledhjes;
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes; dhe
- d) Rendin e ditës.

42.4 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes;
- b) Kohën e mbledhjes;
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes; dhe
- d) Rendin e ditës.

### Neni 43

Çdo anëtar i publikut i cili merr pjesë në mbledhjen e Kuvendin Komunal dhe Komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të takimit, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes. Rregullorja e punës mund të rregullojë të drejtat dhe veprimet e udhëheqësit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

### Neni 44

44.1 Të gjithë anëtarët e Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të emërohen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvendin e Komunës.

44.2 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të Komiteteve tjera.

44.3 Komitetit për Politikë dhe Financa përbëhet prej 9 anëtarëve.

44.4 Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës. Në mungesë të Kryesuesit mbledhjet kryesohen nga njëri prej anëtarëve të këtij Komiteti, kryesuesit e Komiteteve tjera marrin pjesë në mbledhje të këtij Komiteti.

44.5. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumentave fiskale dhe financiare, propozimin e buxhetit, formulimin dhe hulumtimin e drejtimit strategjik të Komunës në të ardhmen, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatime, tarifa dhe pagesa, planin vjetor të punës për auditim të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal dhe marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimi i rekomandimeve Kuvendit të Komunës si dhe shqyrton raportet e punës vjetore të Ndërmarrjeve Publike që janë themeluar nga Kuvendi dhe shqyrton Propozim -Rregulloret që i aprovon Kuvendi i Komunës.

### Neni 45.

Komuna e Glogocit nuk ka komunitet tjera të cilat do mund të identifikohen me një gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe dhe nga kjo bazë nuk formohet Komiteti për Komunitete.

### Neni 46

46.1 Komitetet tjera nëse do të formohen, do të përbëhen prej 5 anëtarëve, shumica e anëtarëve të këtyre komiteteve emërohen nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, duke respektuar përfaqësimin e partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvend.

46.2 Emërimi i anëtarëve jashtë Kuvendit të Komunës duhet të bëhet duke respektuar përvojën adekuate dhe kriteret profesionale.

#### **KAPITULLI IV**

### **INFORMIMI I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**

#### **Neni 47**

47.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga Anëtarët e Kuvendit të Komunës të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale duhet të adresohen me shkrim tek zyrtari i përgjegjës i Komunës nga i cili kërkohen informatat.

47.2 Zyrtari përgjegjës i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet t'i përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

47.3 Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga Kryetari i Komunës, i cili duhet ta shënojë datën e kërkesës së marrë dhe datën e përgjigjes së dhënë.

#### **Neni 48**

Takime të jashtëzakonshme kuvendi i komunës mund të mbajë me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës apo me kërkesën e kryetarit të komunës duke caktuar rendin e ditës, pikat e caktuara për rend dite nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes duke njoftuar me shkrim anëtarët 3 ditë pune para mbajtjes së takimit.

#### **KAPITULLI V**

### **KOMPENSIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS**

#### **Neni 49**

Kompensimi për Anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të komiteteve për punën që ata e bëjnë për komunën duhet të mos tejkalojë rregullat e përcaktuara nga Autoriteti Qendror i Kosovës.

#### **Neni 50**

Anëtarët duhet të kompensohen për punën që ata e bëjnë për komunën me një shumë për pjesëmarrje e cila do të përcaktohet me vendim të veçantë.

## KAPITULLI VI

### KONFLIKTI I INTERESIT I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

#### Neni 51

Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Drejtorëve në Komunë, si dhe Shërbyes Civil e as Udhëheqës i zyrave dhe seksioneve në Komunën ku janë zgjedhur.

#### Neni 52

Përjashtimet për shkak të konflikteve të interesit bëhen në bazë të Nenit 38 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes të Kuvendit të Komunës dhe trupave të saj.

#### Neni 53

Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar nuk duhet të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes atëherë kur diskutohet ajo çështje.

#### Neni 54

54.1 Nëse vjen deri tek ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të implementohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

54.2 Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri.

## KAPITULLI VII

### MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE

#### Neni 55

Kryetari i komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të prezantojë rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të Nenit 28 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale mbi bashkëpunimin ndërmjet komunave të Republikës së Kosovës për ushtrimin e përgjegjësiave dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

### Neni 56

Kryetari i komunës duhet t'i prezantojë rekomandimet e tij tek Kuvendi i Komunës në lidhje me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale dhe a janë të nevojshme ato marrëveshje (Marrëveshjet ndërmjet komunave për mbikëqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike lokale që ofrohen në më shumë se një komunë).

### Neni 57

Kuvendi i Komunës mundet që brenda kornizës së ligjit të bëjë marrëveshje, që të bashkëpunojë dhe të formojë partneritete me kuvendet tjera komunale ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

### Neni 58

Kuvendi i Komunës mund të bashkohet me kuvendet tjera të komunave në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

## KAPITULLI VIII

### PROCEDURAT BUXHETORE

### Neni 59

59.1. Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të komunës janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës, të cilat përgjegjësi edhe mund të barten tek Drejtori i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa. Përrjashtim nga këto çështje bëjnë ato që janë të rezervuara për Kuvendin e Komunës apo Kryetarin.

59.2. Komuna mund të mbledhë të hyra në përputhje me ligjin në fuqi dhe disponon në mënyrë të pavarur me këto të hyra që i takojnë në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës, i cili Vendim duhet të jetë në pajtim me ligjet në fuqi nga;

- a) licencat dhe pagesat që i cakton dhe i vë komuna;
- b) të ardhurat nga pasuria e komunës,
- c) gjobat apo përqindja e gjobave
- d) taksat
- dh) të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës komunale.
- ç) të hyrat nga donatorët,
- g) të hyrat nga vetëkontributet.

### Neni 60

Drejtori i Drejtoratit për buxhet dhe financa obligohet që ta njoftojë Kryetarin dhe Kuvendin e Komunës për çdo veprim që është në kundërshtim me procedurat buxhetore, rregulloret fiskale, rregullat e prokurimit apo Statutin e komunës.

### **Neni 61**

Drejtorët e Drejtorateve të Komunës do ta mbajnë kontrollin financiar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informatave financiare dhe sistemeve funksionuese brenda Drejtoratit të tyre, si dhe duhet t'ia japin të gjitha informatat Drejtorit të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa dhe Auditorit të Brendshëm në veshtrim të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë.

### **Neni 62**

Drejtori i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa duhet t'ia japë këshilla financiare Kryetarit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit, përfshirë këtu edhe vlerësimin financiar të rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga këto organe të Komunës.

### **Neni 63**

Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të komunës janë të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

### **Neni 64**

Drejtori i Drejtoratit të Buxhetit dhe Financave do të paraqesë procedura, rregullore dhe rregulla tjera financiare, që do të jenë në përputhshmëri me procedurat, rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të promovuar një administrim të fortë financiar brenda komunës dhe nga personeli i komunës.

### **Neni 65**

Përcaktimi i të gjitha tatimeve, tarifave dhe pagesave, dhe ndryshimi i tatimeve, tarifave dhe pagesave duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës.

### **Neni 66**

Drejtori i Drejtoratit për Buxhet dhe Financa është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të procesit të buxhetit, duke përfshirë edhe përgatitjen e tij dhe ciklin e konsultimit të brendshëm dhe konsultimit me publikun.

### **Neni 67**

67.1 Konsultimet me publikun duhet të mbahen në kohën ndërmjet mesit të Prillit dhe mesit të Qershorit, në mënyrë që t'u mundësohet të gjithë qytetarëve brenda komunës që t'ia japin mendimet e tyre për të hyrat dhe propozimet për investime të buxhetit.

67.2 Takimet konsultative ku përfshihen të gjitha pjesët e komunës duhet të lajmërohen nëpërmjet mediave lokale një javë para mbajtjes së tyre dhe Drejtori i Buxhetit e Financave, duhet të sigurojë që të gjitha propozimet për investime në infrastrukturën sociale janë evidentuar.

67.3 Propozimet duhet t'i dërgohen Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, së bashku me vlerësimin objektiv të Drejtorit për vlerësimin e çmimit dhe prioritetëve.

67.4 Konsultimet e buxhetit gjithashtu përfshijnë edhe informimin e qytetarëve për potencialin e të hyrave komunale, duke përfshirë edhe tatimin në pronë, dhe masën në të cilën këto të hyra do të mblidhen.

## KAPITULLI IX

### RAPORTI VJETOR

#### Neni 68

Kryetari i Komunës në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko- financiare të komunës dhe zbatimin e planeve investuese së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës.

#### Neni 69

Në mënyrë që të përmbushen përgjegjësitë për raportim të Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet të ndërmerren veprimet si në vijim:

1. Në çdo buxhet vjetor duhet të përfshihen objektivat e komunës në lidhje me aktivitetet për të cilat është përgjegjëse Komuna.
2. Objektivat duhet të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme
3. Duhet të ndërtohen mekanizmat përmes të cilëve monitorohet arritja e objektivave
4. Të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme dhe të përcaktohen mjetet përmes të cilave sigurohet përmbushja e tyre;

## PJESA VI EKZEKUTIVI I KOMUNËS

### KAPITULLI I

#### KRYETARI I KOMUNËS

##### Neni 70

70.1. Kryetari i Komunës së Glllogocit zgjedhët në zgjedhjet e drejtpërdrejta në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale me mandat katërvjeçar.

70.2. Mandati i kryetarit të komunës përfundon;

- a) kur ta kryejë mandatin,
- b) nëse vdes,
- c) nëse jep dorëheqje,
- d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër,
- e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se një muaj pa arsye,
- f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me nenin 64 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale,
- g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike,
- h) në rast të dënimit për veprë penale me vendim për gjashtë(6) muaj ose më tepër

##### Neni 71

71.1. Me rastin e zgjedhjes Kryetari i Komunës bën betimin para anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Përmbajtja e betimit është si vijon:

"Unë \_\_\_\_\_, betohem se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Glllogocit me nder, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë".

71.2. Kryetari i komunës është udhëheqës i degës ekzekutive të komunës.

##### Neni 72

72.1. Kryetari i Komunës ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale:

- a) përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e komunës dhe mbikqyr administrimin financiar;
- c) ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk i ipen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- e) emëron dhe shkarkon Nenkryetarin e Komunës;
- f) emëron dhe shkarkon Drejtorët e Drejtorateve të Komunës;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e komunës;
- h) propozon rregulloret dhe aktet të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;

- i) propozon zhvillimin komunal,planet rregullative dhe investuese,propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike,financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës së paku njëherë në gjashtë(6)muaj apo kurdoherë që kerkohet nga Kuvendi i Komunës;dhe
- k) aktivitete tjera sipas Ligjit.

72.2. Përgjegjësitë tjera të Kryetarit të Komunës janë si në vijim:

- a) I propozon Kuvendit të Komunës aktet, vendimet dhe dispozita të tjera ligjore për aprovim.
- b) Mbikëqyr administrimin e përgjithshëm financiar të Komunës.
- c) Mbikëqyr zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovuara nga Kuvendi i Komunës
- e) Deleton përgjegjësi te anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe mbikëqyr zbatimin e përgjegjësive të deleguara
- f) I propozon Kuvendit të Komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e Drejtorateve dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- g) Jep propozime Kuvendit të Komunës për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve si dhe formon komisione të ndryshme sipas kërkesës së Bordit të Drejtorëve.
- h) Bën caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të drejtorateve sipas nevojës, duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar.
- i) Dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës.
- j)

### NËNKRYETARI I KOMUNËS

#### Neni 73

Kryetari i komunës e ka një nënkryetar i cili emërohet nga kryetari i komunës për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari, ai i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij, kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë kryetari emëron nënkryetarin e ri jo me vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

### BORDI I DREJTORËVE

#### Neni 74

74.1 Kryetari i Komunës për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj ndihmohet nga Bordi i Drejtorëve.

74.2 Bordi i Drejtorëve përbëhet prej drejtorëve të emëruar nga Kryetari i Komunës dhe Udhëheqesi i personelit.

Secili anëtar i Bordit të Drejtorëve:

- a) i raporton rregullisht Kryetarit për çështje që janë në përgjegjësinë e tij;
- b) ndihmon Kryetarin, Kuvendin e Komunës dhe komitetet e tij, duke iu ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;
- c) zbaton të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- d) përgatit programin e punës dhe prezanton raportet periodike të punës për departamentin e tij;
- e) është përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollimin e përditshëm të punës së Departamentit,
- f) përgatit dhe prezanton planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjelljen e këtyre planeve;
- g) përgjigjet në mënyrë efektive për çfarëdo ankese lidhur me sferën e vet të përgjegjësisë;
- h) merr pjesë dhe kontribuon në punën e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij dhe në punën e Bordit të Drejtorëve;
- i) siguron se do të ofrojë një qasje të drejtë dhe të barabartë për ato shërbime publike që janë në përgjegjësinë e tij;
- j) përmbush të gjitha detyrat dhe urdhëresat që i caktohen në mënyrë adekuate.
- k)

#### Neni 75

75.1. Nëse kryetari, për çfarëdo arsye të përcaktuar me ligjet në fuqi, nuk mund t'i kryejë detyrat e tij/saj, të njëjtin do ta zëvendësojë Nënkryetari gjersa të zgjatë kjo pengesë.

75.2. Mandati i Kryetarit të Komunës mund të përfundojë vetëm sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren aktuale mbi zgjedhjet komunale. Në rast të përfundimit para skadimit të rregullt të mandatit të kryetarit mbahen pa vonesë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës. Procedura e revokimit të Kryetarit të Komunës është e njëjtë si edhe procedura e zgjedhjes së tij.

## KAPITULLI II

### DREJTORATET KOMUNALE

#### Neni 76

76.1. Në vështrim të dispozitës së nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës themelon këto Departamente Komunale:

- a. Drejtorati i Administratës së Përgjithshme,
- b. Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- c. Drejtorati për Arsim ;
- d. Drejtorati për Buxhet dhe Financa;
- e. Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit;

- f. Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë;
- g. Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.
- h. Drejtorati i Inspektimit Komunal.
- i. Drejtorati për Bujqësi, dhe Zhvillim Ekonomik dhe
- j. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .

76.2 Në bazë nenit 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës emëron dhe shkarkon Drejtorët e Drejtorateve Komunale, që përfshijnë:

- a) Drejtorin e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- b) Drejtorin e Drejtoratit për Arsim ;
- c) Drejtorin e Drejtoratit për Buxhet dhe Financa;
- d) Drejtorin e Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- e) Drejtorin e Drejtoratit për Shërbime Publike dhe Emergjencë
- f) Drejtorin e Drejtoratit të Inspektimit,
- g) Drejtorin e Drejtoratit për Administratë së Përgjithshme.
- h) Drejtorin e Drejtoratit për Kulturë ,Rini dhe Sport.
- i) Drejtorin e Drejtoratit për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik dhe
- j) Drejtorin e Drejtoratit për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.

76.3 Përpos Drejtorateve, Kuvendi Komunal themelon edhe :

Zyrën e Kryetarit të Komunës ,në kuadrin e se cilës funksionojnë edhe këto zyre:

- Zyra e nënkryetarit,
- Zyra e Udhëheqësit të personelit-Sekretaria.
- Zyra për informim,
- Zyra e auditorit të brendshëm,
- Zyra e avokatit publik,

76.4. Organizimi i brendshëm i këtyre zyrave dhe sistemimi i shërbyesve civilë në vendet e punës do të bëhet në bazë të Rregullorës mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Drejtoratet Komunale.

## DREJTORATI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

### Neni 77

#### Ky Drejtorat:

- a) Kujdeset për funksionimin e administratës komunale duke përfshirë shërbimet e kuvendit dhe ekzekutivit të Komunës;
- b) Mbikëqyr sektorin e ofiqarisë dhe të gjitha shërbimet që kryhen në këtë Sektor;
- c) Kryen detyrat për integritet evropiane;
- d) Organizon logjistikën, siç janë transporti (veturat zyrtare), depon, arkivin, shkrimoren, postën, menaxhimin e pasurisë, shërbimin e sigurimit të mirëmbajtjes së objekteve komunale, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative, futjen e informatave në të;

- e) Ofrimi i bashkëpunimit, këshillave dhe ndihmës Drejtorëve të Drejtorateve në komunë mbi të gjitha çështjet administrative si dhe vlerësimin e rregullt i të arriturave në punë;
- f) Funkionimi dhe organizimi i zyrës së pritjes në vështrim të UA nr. 2006/07 të MAPL;
- g) Vërtetimin e origjinalitetit të dokumentit dhe legalizimi i tij,
- h) Vërtetime të ndryshme sipas specifikave tjera
- i) Menaxhon me pronën komunale dhe
- j) Menaxhon me zyrën e prokurimit në vështrim me Ligjin mbi prokurim.
- k) Menaxhon njësinë për të drejtat e njeriut në vështrim me UA nr.2008/2
- l) Kryen punë tjera të përcaktuar me ligjet përkatëse dhe nga Kryetari i Komunës.

## DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

### Neni 78

#### Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) ofrimin e kujdesit shëndetësor primar në Komunë, në pajtim me dispozitat ligjore;
- b) inspektimin e qendrave private të përkujdesit primar shëndetësor;
- c) vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare;
- d) vendosjen e objektivave lokale për kujdesin primar shëndetësor;
- e) zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë;
- f) koordinon dhe mbikëqyr punën e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe Qendrave Vizitore;
- g) operimin e Qendrës për Punë Sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale;
- h) zhvillimin e planit strehimor për territorin e komunës;
- i) sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- j) Zbatimi i Ligjeve dhe dispozitave tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen shëndetësore dhe mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe të sigurimit social të pjesëmarrësve të luftës, invalidëve ushtarake dhe anëtarëve të familjeve të viktimave civile, dhe
- k) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

## DREJTORATI PËR ARSIM

### Neni 79

#### Ky Drejtorat

- a) Planifikon zhvillimin e arsimit lokal dhe aftësimin e personelit mësimor, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;

- b) nxit bashkëpunimin midis personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit;
- c) siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse me fondet publike të siguruara;
- d) nxjerrë rregulla disiplinore për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në çdo institucion arsimor;
- e) merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave dhe bënë përzgjedhjen e arsimtarëve mësuesve dhe personelit tjetër të shkollave të tri niveleve;
- f) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

### **DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA**

#### **Neni 80**

**Ky Drejtorat është përgjegjës për:**

- a) Hartimin e rregulloreve komunale për çështjet financiare,
- b) Ndhmon Kryetarin e Komunës në përgatitjen e projekt -buxhetit
- c) Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare vjetore
- d) Është përgjegjës për menaxhimin e thesarit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës
- e) Është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit.
- f) Përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
- g) Jep këshilla profesionale nga fusha e buxhetit organeve komunale;
- h) Përlllogaritë dhe cakton tatimin në pronë,taksat Komunale dhe ngarkesat tjera;
- i) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

### **DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT**

#### **Neni 81**

**Ky Drejtorat është përgjegjës për :**

- Menagjon me planit zhvillimor të komunës;
- a) Menagjon me planit të zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të komunës;
- b) harton kriteret për dhënien e lejes së ndërtimit
- c) harton kriteret për dhënien me qira të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të komunës;
- d) mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të komunës;
- e) harton rregullore lokale për kontrollimin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të komunës;
- f) kujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit
- g) Pranimi teknik i objekteve dhe mbikqyrja e punimeve.

- h) Merret me menagjimin e objekteve banesore, harton kriteret e shfrytëzimit të tyre.
- i) Merret me planifikimin e rrjetit të infrastrukturës ( Rrugë, ujësjellës kanalizim)
- j) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

## DREJTORAT I SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

### Neni 82

#### Ky Drejtorat:

- a. Përcakton ofrimin e shërbimeve publike, lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin, kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtore lokale;
- b. Shërbime publike duke përfshirë shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- c. Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave;
- d. Lëshimin e lejeve për shërbime dhe paisje duke përfshirë transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve;
- e. Mbikëqyrë dhe bashkëpunon me kompanitë shërbyese komunale të higjienës dhe furnizimit me ujë;
- f. Në bashkëpunim me kompanitë cakton çmimet e shërbimeve komunale;
- g. Mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues të ujësjellësit;
- h. Cakton prioritete për mirëmbajtje e rrugëve . kanalizimeve dhe ujësjellësin;
- i. Kontrollon buxhetin e ndërmarrjeve shërbyese komunale;
- j. Cakton orarin e reduktimeve dhe prioriteteve;
- k. Bën sigurimin e ujit nëpër pjesët të cilat nuk kanë mundësin të sigurojnë ujin e pijshëm nga rrjeti përmes rezervuarëve , cakton çmimet e shërbimeve, çmimin e ujit, çmimin e kyçjeve të reja;
- l. Organizon aksione të pastërtisë, cakton tarifat për shërbimet e kryera nga ndërmarrjet që bëjnë administrimin e mbeturinave, kujdeset për mirëmbajtjen e tregut të gjelbër dhe të kafshëve;
- m. Kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve të komunës si dhe në sezonin e dimrit bën kryposjen dhe pastrimin e rrugëve dhe shesheve që i përkasin komunës, bën renovimin e rrugëve, mbushjen e gropave etj;
- n. Lëshon lejet për vendosjen e pengesave në rrugët e komunës;
- o. Kryen edhe punë tjera nga lëmia e vetë të përcaktuar nga Kryetari në pajtim me Ligjin përkatës.

## DREJTORAT I INSPEKTIMIT KOMUNAL

### Neni 83

#### Ky Drejtorat

- a. Kryen inspektime në mbështetje të Ligjit për fusha të ndryshme;
- b. Bënë inspektimin e ndërtimeve të objekteve të ndërtimit kolektiv, privatë, objekteve afariste, rrugëve dhe kanalizimeve të ujërave fekale;
- c. Kryen inspektimin në fushën sanitare në mbështetje të Ligjit përkatës;

- d. Kryen inspektimin nga fusha e veterines në mbështetje të Ligjit përkatës;
- e. Kryen inspektimin në fushën e mbrojtjes së ambientit në mbështetje të Ligjit përkatës;
- f. Kryen inspektimin e veprimtarive ekonomike dhe bizneseve të ndryshme në Komunë duke kontrolluar të gjitha bizneset e regjistruara dhe ato të cilat janë të pa regjistruara dhe ndërmer veprimet përkatëse ligjore;
- g. Kryen inspektimin financiar, inspektimin e tregut dhe çmimeve në pajtim me Ligjin përkatës;
- h. Kryen inspektimin nga lëmi i bujqësisë në pajtim me Ligjin përkatës;
- i. Kryen inspektimin e shërbimeve komunale, rrugëve shesheve, parqet, varrezat, përcjellja e trafikut të auto taksive, kombi taksive, autobusëve dhe automjeteve për transport, reklamat e ndryshme të bizneseve dhe të tjera;
- j. Kryen inspektimin rreth parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri si dhe fatkeqësitë tjera elementare;
- k. Kryen inspektimin e kushteve të punës bazuar në Ligjin për Inspektimin ndaj punëdhënësit apo përfaqësuesit të tij dhe ndaj punëtorëve dhe
- l. Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i vet, të përcaktuara nga Kryetari dhe në mbështetje në Ligjet përkatëse.

## DREJTORATI PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI

### Neni 84

#### Ky Drejtorat

- a) bën vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me ligjislacionin në fuqi.
- b) mban regjistrin e pronës së palujtshme dhe regjistrin e tokës komunale si dhe RDPP/në.
- c) bën azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara.
- ç) mbron pronën komunale nga uzurpimet e ndryshme,
- d) zhvillimin e procedurave administrative për kthimin e pronave të uzurpuara,
- e) mbajtjen e evidencës për sipërfaqet e tokës në pronësi private dhe publike,
- f) punët gjeodete lidhur me komasacion,
- g) përpilimin e hartave gjeodezike për hartimin e planeve hapësinore dhe urbanistike të komunës,
- h) lëshimin e certifikatave mbi pronën dhe kopjet e planve pronarëve të paluajtshmërive në bazë të dokumentacionit të verifikuar.
- j) Kryen procedurat e eksproprijimit të tokave në teritorin e Komunës.
- i) Harton kriteret dhe kryen procedurat për dhenjen e tokave komunale në shfrytëzim,
- j) Harton Propozim vendime për qmimin e tokës së eksproprijuar në teritorin e komunës.
- k) kryen edhe punë tjera nga lëmi i vet të përcaktuar nga Kryetari dhe në mbështetje të ligjit përkatës.

## DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM EKONOMIK

### Neni 85

#### Ky Drejtorat:

- a) mban evidencën për tokat bujqësore,
- b) jep pëlqimet për rrikultivimin e tokës bujqësore,
- c) koordinon punët dhe bashkëvepron me OJQ -të që i perkrahin aktivitetet bujqësore,
- d) ofron trajnime përkatëse në lëmin e bujqësisë,
- e) mbron tokën bujqësore prej sëmundjeve të ndryshme,
- f) bën përkehjen e politikave zhvillimore të bujqësisë,
- g) bën mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, rërën dhe aktivitetet për thyerjen e gurëve (gurëthyesve) si dhe merr masa adekuate rreth ruajtjes së tokës bujqësore nga ndërrimi i destinimit të saj,
- h) harton plane për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës,
- i) harton plane për zhvillimin e industrisë dhe zejtarisë,
- j) harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda komunës,
- k) krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duke lëshuar leje konform dispozitave ligjore dhe
- l) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

## DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

### Neni 86

#### Ky drejtorat:

- a) menaxhon në mënyrë të drejtë me të gjitha objektet komunale të kulturës, sportit dhe rinisë.
- b) organizon takime me rëndësi kulturore, sportive dhe rinisë në komunë,
- c) organizon debate për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë në komunë.
- d) harton plane për mbështetjen e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rimore,
- e) kryen punë lidhur me bibliotekat e komunës,
- f) përpunon, sistemon dhe formon fondin e lëndëve arkivore dhe
- g) punë tjera të caktuar nga Kryetari i Komunës.

## PJESA VII

### SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

### Neni 87

87.1. Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të komunës

duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civilë të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

87.2. Drejtorët komunalë e drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civilë të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës ata ku punojnë.

#### Neni 88

88.1. Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit. Kryetari i Komunës shpall, rekruton dhe largon udhëheqësin e personelit në pajtim me ligjin e aplikueshëm për shërbimin civil.

88.2. Udhëheqësi i personelit është shef i personelit të shërbimit civil të Komunës dhe, përveç kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte të veçanta:

- të ketë përgatitjen superiore .
- tri vjet përvojë pune menaxhuese në administratën publike;
- të jetë qytetar i Kosovës;
- aftësi për të drejtuar dhe udhëhequr punët dhe detyrat e besuara në pajtim me Rregulloren dhe Statutin e Komunës;

88.3. Udhëheqësi i personelit, duke vepruar nën autorizimet e përgjithshme të kryetarit të komunës,

- a) kryen detyra që i epen nga Kryetari i komunës ,
- b) njofton kryetarin e komunës për çdo veprim të ndërmarrë që mund të jetë në kundërshtim me ligjin;
- c) është shef i personelit të shërbimit civil komunal, bën zgjedhjen, kushtet e shërbimit dhe largimin e të gjithë shërbyesve civil komunal dhe menaxhohet në përputhje me Ligjin mbi Shërbimin Civil.

88.4. Nëse pozita e Udhëheqësit të Personelit mbetet e zbrazët, Kryetari i Komunës emëron një anëtar të lartë të shërbimit civilë komunalë në cilësinë e kryesit të detyrës së udhëheqësit të personelit dhe brenda afatit prej 60 ditësh kryetari rekruton udhëheqësin e personelit.

88.5. Administrata e komunës është e obliguar të respektojë ligjin dhe çdo veprim administrativ duhet të jetë në pajtim me ligjin në fuqi.

#### Auditori i brendshëm

#### Neni 89

Auditori i brendshëm është i autorizuar dhe ka përgjegjësi që;

- a) të bëjë auditim të brendshëm në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të parapara me Ligjin për auditim të brendshëm,
- b) të marrë, të shqyrtojë dhe t'i shfrytëzojë pa kufizime të gjitha të dhënat teknike, ekonomike, financiare dhe të tjera si dhe informatat dhe dokumentet në dispozicion ose kontroll të subjektit në auditim,

- c) të kërkojë nga cilido zyrtar ose kontraktues i subjektit në auditim, që të ofrojë dëshmi fizike, shënime ose informata të tjera që kanë të bëjnë me auditim dhe
- d) çdo raport i auditimit bëhet publik në pajtim me Ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë.

#### Neni 90

Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga Udhëheqesi i Personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

#### Neni 91

Shërbimi civil komunal duhet të përpiqet të sigurojë balancin e përfaqësimit gjinor duke përfshirë edhe përfaqësimin e saj në të gjitha nivelet.

#### Neni 92

Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.

#### Neni 93

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Udhëheqesin e Personelit do të emërojë një nën - komision detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore që kanë të bëjnë me shërbimin civil komunal në veçanti me çështjet në vijim:

- a) Kategoritë dhe numrat për kategori
- b) Mbikëqyrja dhe përgjegjësitë
- c) Detyrat dhe obligimet
- d) Delegimi i detyrave dhe obligimeve
- e) Rekrutimi dhe përzgjedhja
- f) Kushtet e pranimit
- g) Fillimi i punës në zyrë, puna provuese dhe lista rezervë
- h) Procedurat ankimore
- i) Procedurat e kundërshtimeve
- j) Trajnimi dhe provimet
- k) Rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit
- l) Përparimi dhe suksesi në karrierë
- m) Dosjet dhe referencat e stafit
- n) Kohëzgjatja e punësimit dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punësimit
- o) Pagesat dhe shpërblimet tjera
- p) Pagesa për udhëtim dhe mëditjet
- q) Pushimi
- r) Rregullat e shërbimit civil komunal

## VEPRIMET DHE AKTET JURIDIKE

### Neni 94

Të gjitha organet e Administratës Komunale kur ndërmarrin veprime juridike duhet t'u përmbahen Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjeve, Statutit, Rregulloreve dhe akteve tjera nënligjore të cilat janë në fuqi.

Në ushtrimin e funksioneve të administratës zbatimin e dispozitave dhe akteve të tjera, organet e administratës dhe udhëheqësit e tyre nxjerrin akte përkatëse juridike në pajtim me Ligjin për procedurën administrative dhe Ligjet tjera të çështjes konkrete administrative.

Aktet juridike që i nxjerrin organet e administratës janë: Rregulloret, Vendimet, Aktvendimet, Udhëzimet, Urdhëresat, Konkluzionet dhe aktet e tjera juridike nënligjore në domenin e administratës,

Organet e administratës në bazë të kërkesës së palës dhe sipas detyrës zyrtare lëshojnë edhe akte siç vijon: Vërtetime, Certifikata dhe akte tjera sipas evidencës zyrtare me të cilën disponon administrata e në pajtim me Ligjin mbi Procedurën Administrative.

## INCIATIVA E QYTETARËVE

### Neni 95

94.1. Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore brenda kompetencave komunale për miratim nga Kuvendi apo me votën e qytetareve në pajtim me ligjin në zbatim.

94.2. Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar Kryesuesit të Kuvendit të Komunës i cili draft duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar të Komunës dhe Kuvendi i Komunës në afatin prej 60 ditësh pas pranimit është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar.

94.3. Qytetarët e komunës mund të marrin iniciativë për largimin e kryetarit të komunës, kërkesa duhet të nënshkruhet nga 20% e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit të komunës i cili paraqet çështjen në institucionet përkatëse për administrimin e votimit dhe nese shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit zgjedhjet e reja për kryetar të komunës do të mbahen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet.

## ANKESA DHE MBROJTJA JURIDIKE

### Neni 96

Pala mund të parashtojë ankesë ose kundërshtim kundër vendimeve apo aktvendimeve administrative të organit të administratës nëse mendon se me atë Vendim apo Aktvendim janë cenuar të drejtat e tij ose të saj. Ankesat i dorëzohen me shkrim

Organit që ka vendosur në shkall të parë personalisht në arkivin komunal apo përmes postës brenda afatit prej 30 ditësh pasi paraqitësi i ankesës të ketë mësuar për Vendimin dhe lënda do të procedohet organit të shkallës së dytë për vendosje në veshtrim të Ligjit mbi Procedurën Administrative.

## **MARRËDHËNIET NDËRMJET PUSHTETIT QENDROR DHE LOKAL**

### **Neni 97**

Shqyrtimi administrativ i Komunave ushtrohet në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin.

Ministria për Qeverisje Lokale është autoritet mbikëqyrës, nëse me ligj nuk parashihet ndryshe ndërsa shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga Organi i Qeverisë Qendrore që i ka deleguar.

Kryetari i Komunës është përgjegjes për t'i vënë në dispozicion informata autoritetit qendror dhe brenda 10 ditësh është i obliguar autoritetit mbikëqyrës t'i dërgon të gjitha aktet e miratura nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi në muaj të paraprak,

Shqyrtimi i ligjshmerisë nga autoriteti mbikëqyrës behet në pajtim me nenin 81 dhe 82 të LVL.

## **PASURIA E KOMUNËS**

### **Neni 98**

Komuna përmes Administratës së Përgjithshme kujdeset, përgatit dhe mban shënimet e sakta për pasurinë komunale.

Çështja e pasurisë komunale është përcaktuar në dispozitat e nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjeve tjera pozitive që e rregullojnë këtë çështje.

## **PJESA VIII**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 99**

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave statutores me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dispozitat e Ligjit do të mbizotërojnë.

#### **Neni 100**

Ky statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimin të tij nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti pushojnë të vlejshme dispozitat e statutit të Kuvendit të Komunës së Glllogocit të datës 29.05.2008 dhe aktet tjera që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij statuti.

## Neni 101

Me aprovimin e këtij statuti të gjitha aktet tjera të komunës do të harmonizohen me statutin në fuqi në afat prej 6 muajve.

## Neni 102

Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës

Nr. 110-6904  
Glllogoc, 17.09.2008



**KRYESUESI I KUVENDIT**

*Idriz Hysenaj*  
Idriz Hysenaj